



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
 AGENCJA ZA SPRJECAVANJE KORUPCIJE
 THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
 AGENCJA ZA SPRJECAVANJE KORUPCIJE
 THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

DATË/A:	18.09.2023	Dep. Dep. Dep. Nr. Faq. Br. Sh. Nr. Paga. 03/03 04	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 1731/23 Data Datum Date 19-09-2023
REFERENC-Ë:	APK- DPKPP /03-03-1681/23		
PËR/ZA/TO:	z. Astrit MULLABAZI, Menaxher i Zyrës së Prokurimit, Komuna e Rahovecit		
CC:	z. Smajl LATIFI, Kryetar i Komunës së Rahovecit		
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ylli BULESHKAJ, Drejtësor i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit		
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtësor i Departamentit për Parandalimin e Korruptionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderët me titull: “Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec-Ritenderim”		

Inderuar z. Mullabazi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënparr. 1.1.1) dhe 8 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, nenit 9 (par. 1, nënparr. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korruptionit, lidhur me tenderin me titull: **“Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec-Ritenderim”** me numër të prokurimit: 623/23/9402/511, Agjencia për Parandalimin e Korruptionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin rekomandoheni që si Autoritet kontraktues t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderët: **“Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec-Ritenderim”** me numër të prokurimit: 623/23/9402/511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04/L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyjetimi

Agjencia pér Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njostimeve pér kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 07 shtator 2023, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: *APK-03-03/1681/23*, pér fllimin e procedurës pér trajtimin e rastit pér parandalimin e konfliktit të interesit dhe parregullsive tjera të mundshme në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: “**Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec-Ritenderim**” me numër të prokurimit: 623/23/9402/511, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Rahovecit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njostimin pér kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, pér këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike, të llojit punë, me vlerë të madhe të parashikuar prej 2,983,063.00€.

Gjatë analizimit të njostimit pér kontratë dhe dosjes se tenderit të aktivitetit të prokurimit “**Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec-Ritenderim**”, Agjencia në këtë fazë të procesit të prokurimi nuk ka identifikuar ndonjë situata ku është shfaqur konflikti i interesit.

Por, në kuadër të rubrikës III.2.4. Kapaciteti teknike dhe profesionale kërkesa 2., Agjencia vëren se, Autoriteti kontraktues ka kërkuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë dëshmi, ku thuhet: *Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose master, me përvojë pune min. 10 vite pas diplomimit, i njëjti duhet te jetë i certifikuar si përgjegjës pér sigurimin dhe kontrollin e Cilësisë dhe nga lëmia e sigurisë, shëndetit në punë dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar.* Kërkosë kjo pér të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Ligjit në fuqi pér Prokurimin Publik.

Në nenin 69 paragrafi 6 të Ligjit në fuqi pér Prokurimin parashihet: “Për të vërtetuar astësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, në procedurat që shpjinë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet astësia e tyre teknike dhe profesionale pér kryerjen e projekteve të tillë ose realizimin e aktiviteteve të tillë”. Ndërsa në nën paragrafin 6.1 të nenit 69 paragrafi 6 thuhet: kualifikimet shkolllore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës pér realizimin e projekteve të punës ose pér realizimin e aktiviteteve ndërtimore.

Agjencia konsideron, që në përputhje me legjisacionin e zbatueshëm, autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të projekteve pér menaxherin e projektit të ketë menaxhuar se paku 2 (dy) projekte nga lëmia e kërkuar. E rëndësishme pér autoritetin kontraktues është që ta vërtetoj se operatorët ekonomik kanë kryer projekte në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të

njoftimit për kontratë, e jo si në rastin konkret ku është kërkuar numër i projekteve të menaxhuara për menaxherin e projektit, sepse kërkesa e tillë mund ta kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm ekonomik, teknik-profesional.

Gjithashtu, në kuadër të rubrikës IV.2. Kriteret e dhënies. Agjencia vëren se autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin *Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*, ndërsa si nën kritere ka caktuar: **1.** Çmimin të cilët i ka caktuar koeficientin prej 70%, **2.** Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës deri në maksimum 960 ditë. Ndërsa konform normave ndërtimore afati minimal i implementimit është 450 ditë koeficientin prej 20%, dhe Afati me i gjatë i periudhës garantuese deri në maksimum 3 vite koeficientin prej 10%.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit **2.** "Afati me i gjatë i periudhës garantuese" nuk ka respektuar Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik, përfshirë faktin se në nenin 27 paragrafi 3 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimi Publik, specifikohen qartë cilat kriter mund të caktohet te kriteri i dhënies Tenderi ekonomikisht ma i favorshëm. Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues periudhën garantues mund t'a specifikojë në Kushtet e veçanta të kontratës ashtu siç parashihet në nenin 34.5

Në nenin 27 paragrafi 3 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimi Publik, parashihet se " Nëse kriter për dhënie të kontratës është Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, kontrata duhet t'i jepet tenderit i cili më së miri përbushë kriteret relevante. Përveç, çmimit Autoriteti kontraktues mund të përfshijë kriteret tjera relevante për lëndën e kontratës. *Për shembull, mund të përfshihet: karakteristikat e cilësisë, kostot operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë, karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme, shërbimi i pas-shtimes dhe asistencia teknike.*

Autoriteti kontraktues duhet të këtë kujdes që në rast se përcaktohet për këtë kriter për dhënie të kontratës të caktoj nën kritere të qarta, precize, të matshme dhe të cilat kriterë janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, Agjencia për Parandalimin e Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim dhe Jo-diskriminimi, me nenin **52**. Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, si dhe nenin **69 paragrafi 6. nën paragrafi 6.1.** Afërsitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenin **8** i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik, si dhe nenin 27 paragrafi 3 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimi Publik, andaj autoriteti kontraktues rekomandohet të veprojnë në harmoni të plotë me dispozitat e LPP-së dhe legjislacionin sekondar për prokurimi publik.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura të APK-së do të njoftohet edhe KRPP.

Kërkojmë nga Autoritetet Kontraktuese që të na informojnë për veprimet eventuale të ndërmarra si rezultat i këtij opinioni.

Me respekt!

